



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 08/L - 031

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT “PROJEKTI EMERGJENT I KOSOVËS PËR COVID-19 – FINANCIM SHITESË”, NË MES TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE ASOCIACIONIT NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIM

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT
“PROJEKTI EMERGJENT I KOSOVËS PËR COVID-19 – FINANCIM
SHITESË”, NË MES TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE
ASOCIACIONIT NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIM**

Neni 1
Qëllimi

Ky Ligj ka për qëllim që të ratifikojë Marrëveshjen e Financimit “Projekti Emergjent i Kosovës për COVID-19 – Financim shtesë”, në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.

Neni 2
Ratifikimi i Marrëveshjes

Me anë të këtij Ligji ratifikohet Marrëveshja e Financimit “Projekti Emergjent i Kosovës për COVID-19 – Financim shtesë”, në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.

Neni 3
Dokumentet e bashkëngjitura

Në Shtojcën e këtij Ligji është e bashkëngjitur teksti i Marrëveshjes për Financim Shtesë.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 08/L-031
4 tetor 2021

Glauk KONJUFCA

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës